



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-05

Vendosi: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 12 qershor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i redaktuar publik i
fletarrestimit për z. Salih Mustafa**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

T'i dorëzohet

Z. Salih Mustafa

UNË, GJYKATËS NIKOLA GIJU, gjykatës i procedurës paraprake i Dhomave të Specializuara të Kosovës, i caktuar prej Kryetares së Dhomave të Specializuara në përputhje me nenin 33(1)(a) të Ligjit nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”);

PASI KAM MARRË parashtrimet konfidenciale dhe *ex parte* të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) me titull “Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesave në lidhje me të” të datës 14 shkurt 2020, “Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim dhe kërkesave në lidhje me të” të datës 18 mars 2020 dhe “Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për Herë të Dytë për konfirmim” të datës 20 mars 2020;

PASI KAM KONFIRMUAR Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë (“Aktakuza e Konfirmuar”) në “Vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës” të datës 12 qershor 2020, dhe pasi kam konstatuar aty se ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Salih Mustafa (“z. Mustafa”) ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara;

BAZUAR NË nenet 35(3), 39(3), 41,53, 54 dhe 55 të Ligjit dhe rregullave 50, 53, 55, 86(6)(b) dhe 208(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”);

LËSHOJ FLETARRESTIM PËR

SALIH MUSTAFËN, gjithashtu i njohur si “Cali” apo “Komandant Cali”, i lindur më **1 JANAR 1972** në **PRISHTINË**, Kosovë, aktualisht me shtetësi kosovare, **NUMRI PERSONAL [REDAKTUAR]**, me adresë të fundit të ditur [REDAKTUAR], **PRISHTINË**, Kosovë.

A. VEPRAT PENALE DHE PARAQITJE E SHKURTËR E FAKTEVE

1. Sikurse parashtrohet në Aktakuzën e Konfirmuar, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Mustafa mban përgjegjësi penale për krimet e luftës të: ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2), torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4), në shkelje të nenit 14(1)(c) të Ligjit. Në lidhje me këto krime, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Mustafa mban përgjegjësi penale, në bazë të nenit 16(1)(a) të ligjit, për:

- (i) kryerje fizike të krimeve të përfshira në Pikat 1-3;
- (ii) kryerje, si anëtar i një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët ("NKP"), të krimeve të përfshira në Pikat 1-4, dhe ndryshe, lidhur me Pikën 4, si anëtar i NKP-së së lartpërmendur, kryerje të krimit të vrasjes së paligjshme, duke qenë i vetëdijshëm se një krim i tillë mund të kryhet gjatë realizimit të qëllimit të përbashkët të NKP-së dhe duke e marrë përsipër këtë rrezik me vullnet të lirë;
- (iii) urdhërim të krimeve të përfshira në Pikat 1-3;
- (iv) nxitje të krimeve të përfshira në Pikat 1-3; dhe
- (v) gjithashtu, dhe ndryshe, ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e krimeve të përfshira në Pikat 1-4.

2. Më tej dhe ndryshe prej përgjegjesisë së pretenduar në bazë të nenit 16(1)(a) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Mustafa mban përgjegjësi penale për krimet e përfshira në Pikat 1-4 si epror, në bazë të nenit 16(1)(c) të Ligjit.

3. Sikurse përshkruhet në Aktakuzën e Konfirmuar, këto krime u kryen kundër së paku gjashtë (6) personave të cilët nuk merrnin pjesë aktivisht në luftime, në kompleksin e ndalimit në Zllash, Kosovë ("kompleksi i ndalimit në Zllash"), afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999. Sikurse përshkruhet në Aktakuzën e Konfirmuar, krimi i luftës i vrasjes së paligjshme (Pika 4) u krye në kompleksin e ndalimit në Zllash kundër një (1) të ndaluarit, në një datë afërsisht midis 19 prillit dhe rreth fundit të prillit 1999.

4. Krimet e përfshira në Pikat 1-4 u kryen në kontekstin e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe kishin lidhje me këtë konflikt midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë ("RFJ") dhe Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave, njësite policore dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe grupe të tjera që luftonin në emër të RFJ-së dhe të Serbisë.

B. DOMOSDOSHMERIA E ARRESTIMIT

5. Arrestimi i z. Mustafa është i domosdoshëm në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit. Ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se: (i) ekziston rreziku i arratisjes, duke qenë se ai është në dijeni të vendimeve për fajësi penale të ish komandantëve të lartë të Zonës Operative të Llapit, të cilat janë raportuar publikisht; është në dijeni të akuzave kundër tij, sikurse paraqiten në Aktakuzën e Konfirmuar, si dhe të dënimeve të mundshme; është pjesë e aparatit të sigurisë dhe inteligjencës të Kosovës dhe rrjedhimisht ka qasje në informacion dhe burime, dhe ka mundësinë të udhëtojë lirisht; (ii) mund të pengojë procedurën gjyqësore me anë të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve, viktimave, ose bashkëkryesve; dhe (iii) duke marrë parasysh sjelljen dhe veprimet e tij në të kaluarën, mund të kryejë krime të tjera, duke qenë se është mburrur publikisht për ekzekutimin e serbëve, çka demonstroi rrezikun e përdorimit prej tij të dhunës fizike ose të kërcënimit për përdorimin e dhunës fizike kundër viktimave dhe dëshmitarëve.

C. ZBATIMI I FLETARRESTIMIT

6. Duke qenë se sipas informacionit aktualisht të disponueshëm z. Mustafa jeton në Kosovë, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëron ZPS-në të zbatojë dhe dorëzojë këtë fletarrestim. Në bazë të nenit 35(3) të Ligjit, policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka Policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës dhe rrjedhimisht mund të konsiderohet "autoritet

kompetent" në bazë të rregullës 49(1) të Rregullores për zbatimin dhe dorëzimin e këtij fletarrestimi. Gjykatësi i procedurës paraprake rikujton se, në bazë të neneve 53(3) dhe 54(1) të Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë përparësi kundrejt të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë, dhe se ky fletarrestim ka fuqi dhe efekt të njëjtë me fletarrestimet e lëshuara nga cilado gjykatë tjetër e Kosovës. Në përputhje me nenin 53(1) të Ligjit, të gjithë subjektet dhe personat në Kosovë, ndër të cilët zyrtarë qeveritarë, bashkëpunojnë me ZPS-në dhe Dhomat e Specializuara dhe përmbushin pa vonesë çdo urdhër ose vendim të tyre.

7. Në qoftë se ekziston informacion se z. Mustafa ndodhet në territorin e një shteti të tretë, Administratorja ua përcjell fletarrestimin autoriteteve kompetente të atij shteti, me kërkesë që fletarrestimi të zbatohet dhe dorëzohet në praninë e përfaqësuesve të ZPS-së, në përputhje me nenin 55 të Ligjit. Prej shtetit të tretë gjithashtu kërkohet që të informojë menjëherë Administratoren për datën, orën, vendin dhe çdo hollësi tjetër të rëndësishme lidhur me arrestimin dhe transferimin e z. Mustafa në Dhomat e Specializuara, në përputhje me nenin 55 të Ligjit. Në rast se hasin në vështirësi apo pengesa teknike ose logjistike gjatë zbatimit të këtij fletarrestimi, autoritetet kompetente të shtetit të tretë ftohen që të informojnë përfaqësuesit e ZPS-së dhe/ose të Zyrës Administrative, sipas rastit, për këto vështirësi ose pengesa.

D. TRANSFERIMI DHE OBJEKTI I PARABURGIMIT

8. Në përputhje me nenin 3(8)(a) dhe (d), dhe nenin 41(5) dhe (7) të Ligjit, si dhe rregullën 55(4) të Rregullores, pas arrestimit z. Mustafa transferohet në objektin e paraburgimit në Holandë ("shteti pritës"), i mbikëqyrur nga Dhomat e Specializuara dhe i administruar nga Zyra Administrative. Administratorja zbaton urdhrin për transferim dhe bën përgatitjet e nevojshme për transferimin e menjëhershëm të z. Mustafa.

E. TË DREJTAT E Z. MUSTAFA

9. Pas arrestimit, z. Mustafa gëzon të drejtat e parapara në nenet 21 dhe 41(4) të Ligjit, të cilat duhet t'i lexohen në kohën e arrestimit nga ZPS-ja, ose pas transferimit në paraburgim të Dhomave të Specializuara, sipas rastit.

10. Z. Mustafa sillet para gjykatësit të procedurës paraprake pa vonesë, në përputhje me nenin 41(5) të Ligjit.

11. Në bazë të nenit 41(2) dhe (5) të Ligjit, z. Mustafa ka të drejtë t'i paraqesë gjykatësit të procedurës paraprake ankesë lidhur me ligjshmërinë e arrestimit të tij, të urdhrin për transferim dhe kushtet e paraburgimit, si dhe të paraqesë apel në Dhomën e Specializuar të Gjykatës së Apelit.

F. KËRKESA DHE URDHRA TË TJERË

12. Ky fletarrestim, aktualisht i klasifikuar si konfidencial dhe *ex parte*, mund t'u komunikohet, ose ekzistenca e tij mund t'u bëhet e ditur, të akuzuarit z. Mustafa dhe autoriteteve të tjera kompetente të Kosovës ose të shteteve të treta, ndër të cilat shteti pritës, nëse është e nevojshme për zbatimin e tij.

13. Duke marrë parasysh klasifikimin e këtij fletarrestimi, gjykatësi i procedurës paraprake kërkon prej autoriteteve kompetente të Kosovës ose të cilitdo shteti të tretë, sipas rastit, të mos ia bëjnë të ditur askujt ekzistencën e këtij fletarrestimi dhe përmbajtjen e tij, përveçse atyre personave përfshirja e të cilëve është absolutisht e domosdoshme për zbatimin e fletarrestimit dhe dorëzimin e tij z. Mustafa.

14. Në rast se një subjekt, një zyrtar i qeverisë së Kosovës, ose cilido person tjetër në Kosovë, pengon zbatimin e këtij fletarrestimi, kjo mund të përbëjë shkelje në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.

_____/nënshkrim/_____

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i procedurës paraprake

E premte, 12 qershor 2020
Në Hagë, Holandë.